

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"AL-JAHA SOLAR" SHPK

Sot, më datë 26/10/2022, u paraqit personalisht:

- **Z. Fadil Hoxha**, e datëlindjes 27/12/1973, shtetas gjerman, lindur ne Podujeve dhe banues ne Kosovë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i pasaportes me Nr. C4TR6J3262 dhe Nr. Personal 7312276M2702238.

i cili përpiloi këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare "AL-JAHA SOLAR" SH.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Forma Ligjore

Të themeloj Shoqërinë Tregtare " AL-JAHA SOLAR " SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri " AL-JAHA SOLAR " SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit " AL-JAHA SOLAR " SH.P.K dhe me emrin tregtar AL-JAHA SOLAR. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Realizimi i impianteve fotovoltaike dhe eolike për gjenerimin e energjisë elektrike
- Projektim,ndertirn, dhe mirmbajtje te centraleve gjeneruese per prodhimin e energjise elektrike nga burime te rinovueshme
- Ndërtimi i projekteve të shërbimeve publike për energji elektrike dhe telekomunikime
- Projektim, zbatim, mirembajtje, dhe asistence teknike te impianteve elektrike
- Tregtimi i mallrave te ndryshme, materialeve elektrike dhe elektronike speciale qe kane te bejne me tipologjine e impianteve fotovoltaike dhe eolike dhe ne pergjithesi te çdo produkti industrial, makinerive dhe pajisjeve, lendeve te para, te teknologjive te ndryshme, si dhe import eksport i ketyre mallrave.



NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: **Dyqan Kati I, Pallati "GORA", Bulevardi "Gjergj Fishta", Tiranë.**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është Lekë 800.000 (teteqind mije leke) dhe zotërohet nga ortakët themelues:

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: Lekë 800.000 (teteqind mije leke)

Vlera e paguar: 800.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

NENI 7

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare " **AL-JAHA SOLAR** " SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortaku themelues :	Fadil Hoxha
Numri i kuotave :	1
Numri i pjeseve :	1
Pjesëmarrja në Shoqëri :	100,00 %
Lloji i kontributit:	Ne para
Vlera e kontributit	800,000 (teteqind mije) leke

Duke qenë se Kapitali themeltar do të depozitohet në llogarinë e Shoqërisë e cila do të hapet pas regjistrimit në QKB, atëherë ortakët vendos që kjo shume do të paguhet prej tij jo më vonë 3 muaj nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, në llogarinë e shoqërisë tregtare. Rregullat e pagesës së kesaj shume janë parashikuar në këtë Statut.

NENI 8

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9

Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërisë do të jetë :



- **Z. Leonard Beqiri**, i datëlindjes 08/04/1966, shtetas shqiptar, lindur ne Vlore dhe banues ne Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i leternjofimit me Nr. 034767339 dhe Nr. Personal G60408206J.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues, u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaku eshte njohes te gjuhes shqipe.

ORTAKU THEMELUES

Fadil Hoxha

